

UDHËTIM NË EGJIPT

Dita 1 / 25 Nëntor : Tiranë – Kairo

Takimi me guidën rreth orës 03:30 në aeroport. Nisja nga Tirana në orën 06:00. Udhëtojmë drejt Vienës, mbërrimë në orën 07:35. Marrim fluturimin për në Kairo në orën 11:10. Mbërritja në orën 15:35.

Me të mbërritur në **Aeroportin Ndërkombëtar të Kairos**, do të takohemi me partnerët dhe do të transferohemi në hotelin tonë për të bërë check-in. Pas një udhëtimit të gjatë, do të shijojmë një darkë të këndshme në restorantin e hotelit përpara se të pushojmë natën.

Fjetja në **Jaz Pyramids**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Darka

Dita 2 / 26 Nëntor : Aswani dhe Lundrim në Nil

Zgjahemi dhe marrim mëngjesin me vete për të nisur eksplorimin e ditës.

Transferohemi për në Aswan me avion. Do të vizitojmë **Digën e Lartë**, një arritje e jashtëzakonshme inxhinierike që mban ujërat e **lumit Nil** dhe krijon **Liqenin Nasser**. Më pas, do të vazhdojmë drejt **Parkut Redgranite Quarry**, ku ndodhet një **obelisk i papërfunduar**, një strukturë e lartë 41 metra, që tregon teknikën e lashtë të nxjerrjes së blloqeve të gurit nga shkëmbi.

Më pas do të transferohemi në **kroçerën** tonë në lumin Nil dhe do të akomodohehi në bord. Pas drekës, në pasdite, do të bëjmë një shëtitje të këndshme me felucca, një varkë tradicionale peshkimi, për të përjetuar qetësinë dhe bukurinë e lumit Nil. Në mbrëmje do të shijojmë një darkë në bord dhe do të kalojmë natën në kroçerë.

Fjetja në **Kroçere (Le Fayan II)**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka

Dita 3 / 27 Nëntor : Kom Ombo dhe Lundrim në Nil

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin në kroçere.

Më pas, do të vazhdojmë udhëtimin tonë me kroçerë drejt **Kom Ombo**, që ndodhet 40 kilometra larg nga **Aswani**. Do të vizitojmë **Tempullin e Kom Ombos**, i cili është i veçantë për ndarjen e tij mes dy perëndive, Sobekut me kokë krokodili dhe Haroerisit me kokë shqiponje. Gjithashtu, do të shohim **Nilometrën**, një instrument që egjiptianët e lashtë e përdornin për të matur nivelin e ujit të Nilit.

Pas vizitës, do të kthehemi në bord për drekë dhe do të vazhdojmë lundrimin. Në mbrëmje do të kemi një darkë të këndshme dhe do të kalojmë natën në kroçerë.

Fjetja në **Kroçere (Le Fayan II)**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka

Dita 4 / 28 Nëntor : Edfu dhe Lundrim në Nil

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin në kroçere.

Në mëngjes do të vizitojmë **Tempullin e Edfusë**, një nga tempujt më të ruajtur në Egjipt, i dedikuar perëndisë Horus. Udhëtimi nga kroçera deri në tempull do të bëhet me karrocë me kuaj. Do të kemi kohë për të eksploruar këtë tempull mbresëlënës përpara se të kthehemi në kroçerë për të vazhduar udhëtimin drejt **Luksorit**, duke kaluar përmes **digës së Esnës**. Pasdite do të shijojmë një drekë në bord dhe në mbrëmje do të kemi një darkë të këndshme përpara se të pushojmë.

Fjetja në **Kroçere (Le Fayan II)**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka

Dita 5 / 29 Nëntor : Luksor dhe Lugina e Mbretërve

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin në kroçere.

Më pas do të vizitojmë një nga komplekset më të rëndësishme të monumenteve në Egjipt, **Tempullin e Karnakut dhe Luksorit**. Më pas, do të vazhdojmë drejt **Luginës së Mbretërve**, ku ndodhen varret e faraonëve më të shquar të Egjiptit të lashtë. Do të kemi mundësinë të eksplorojmë këto varre të gdhendura në shkëmb, të cilat janë zbuluar me relievet e mahnitshme.

Më pas do të vizitojmë **Tempullin e Deir El Bahari**, një monument madhështor ndërtuar nga Mbretëresha Hatshepsut, një nga sundimtaret më të shquara të Egjiptit të lashtë. Do të vazhdojmë me vizitën në **Tempullin Medinat Habu**, që i është kushtuar Ramsesit III dhe shquhet për relievet e tij të ruajtura në mënyrë të shkëlqyer. Para se të

përfundojmë ditën, do të ndalojmë pranë **Kolosëve të Memnonit**, dy statuja gjigante që dikur ishin pjesë e një tempulli faraonik.

Në varësi të orarit të fluturimit, do të kemi kohë të lirë për të eksploruar më tej përpara se të transferohemi në aeroportin e Luksorit dhe më pas të kthehemi në Kairo për një tjetër natë në hotel.

Konsumojmë darkën. Fjetja në **Jaz Pyramids**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Darka

Dita 6 / 30 Nëntor : Piramidat dhe Sfinksi

Zgjohemi dhe konsumojmë mëngjesin.

Do të vijojmë me vizitën e kompleksit të famshëm të **Piramidave të Gizës**, përfshirë **piramidat e Keopsit, Kefrenit dhe Menkaurës**. Gjithashtu, do të shohim **Sphinxin** enigmatik, një nga simbolet më të njohura të Egjiptit të lashtë.

Pas vizitës, do të kemi kohë të lirë ose mundësinë për të marrë pjesë në një vizitë opsionale në **Memfis** dhe **Sakkara**. Memfisi ishte një qendër e rëndësishme e adhurimit të perëndisë Ptah dhe shquhet për Kolosin e Ramsesit II. Në perëndim të Memfisit ndodhet nekropoli i madh i Sakkaras, një nga varrezat më të vjetra mbretërore.

Konsumojmë darkën në hotel. Fjetja në **Jaz Pyramids**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Darka

Dita 7 / 01 Dhjetor : Nisja nga Egjipti

Zgjohemi dhe konsumojmë mëngjesin.

Pas mëngjesit në hotel, do të përgatitemi për largimin nga Egjipti. Do të transferohemi në Aeroportin Ndërkombëtar të Kairos sipas orarit të fluturimit tone 16:35 , duke marrë me vete kujtime të paharrueshme nga ky udhëtim i jashtëzakonshëm në Tokën e Faraonëve.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi

DETAJE RRETH HOTELEVE :

Jaz Pyramids / Cairo :

Adresa : Cairo - Alexandria Desert Rd, Kerdasa, Giza Governorate 12556, Egypt

Nr. Tel : [+20 2 38387333](tel:+20238387333)

Le Fayan II / Kroçiere

Në çdo rast pakujdesie apo largimi nga grupi, pa mundur të ribashkoheni, gjithmonë mund të merrni një taxi dhe t'i tregoni vendndodhjen e hotelit në bazë të qytetit ku ndodheni

DETAJE RRETH FLUTURIMIT :

Fluturimi Shqiperi – Egjipt 24 Nëntor 2025

Tiranë (TIA) – Vienë (VIE) : 06:00 – 07:35

Vienë (VIE) – Cairo (CAI) : 11:10 – 15:35

Fluturimi Egjipt – Shqiperi 01 Dhjetor 2025

Cairo (CAI) - Vienë (VIE) : 16:35 – 19:20

Vienë (VIE)– Tiranë (TIA) : 23:20 – 00:50 (2 Dhjetor)

DETAJE RRETH GUIDËS :

Guida Shqiptare : z.

Nr. Tel :

Guida Egjiptiane :

Nr. Tel :

DETAJE RRETH INTERNETIT / PARAVE :

Mund të blini kartë SIM në aeroport në Baku ose të bëni roaming me kartën tuaj aktive në Shqipëri. Një mënyrë tjetër është të blini një E – Sim në internet dhe ta instaloni në bazë të pajisjes tuaj celulare.

Përsa i përket parave, lekët mund ti shkëmbeni në monedhën vendase, pound Egjiptian (EGP) në aeroport. Monedhat kryesore të forta si USD, EURO, GBP mund të shkëmbehen lehtësisht. Ka bankomate ATM kudo dhe pranohen kartat ndërkombëtare. Guida shoqëruese do të ndihmojë nëse është e nevojshme.

DETAJET E TURIT

Përfshihen në çmim :

- Fluturimi Vajtje / Ardhje
- Fluturimi Cairo – Aswan (~ 1.5 orë)
- Fluturimi Luxor – Cairo (~ 1 orë)
- 3 netë akomodim në hotel me 4* në Cairo me mëngjes dhe darkë
- 3 netë akomodim në kroçiere me mëngjes, drekë dhe darkë
- Transfertat me autobus komod sipas programit
- Shërbimi i guidës lokale në anglisht
- Shoqërues shqiptare nga Agjensia gjatë të gjithë udhëtimit
- Hyrja në monumentet e përmendura në program
- VISA

Nuk përfshihen në çmim :

- Vaktet të cilat nuk përmenden në program
- Shpenzime personale
- Sigurimi i jetës
- Cdo aktivitet qe nuk permendet ne rubriken “përfshihet”

Politikat e Shërbimit

Rezervimi me Elite Travel Agency është i sigurt dhe i thjeshtë

PA KOSTO TË FSHEHURA

Shikoni çdo çmim të mundshëm pa tarifa rezervimi ose kosto të tjera të fshehura.

SIGURI NË TRANSAKSIONET TUAJA

Ne ndjekim standardet më të larta të protokolleve të sigurisë për t'i ofruar mysafirëve tanë siguri "online".

POLITIKAT E PRIVATËSISË

Ne interesohemi për privatësinë e të dhënave tuaja personale dhe marrim të gjitha masat për t'u siguruar që jemi duke ecur me hapin e kohës përsa i përket rregullave për mbrojtjen e të dhënave.

SHËRBIMI NDAJ KLIENTIT

Rezervimi në faqen tonë është i shpejtë dhe i thjeshtë. Nëse keni kërkesa specifike, ekipi ynë I Operacioneve do të jetë gati për t'ju asistuar.

KONFIRMIMI I REZERVIMIT ME E-MAIL

Menjëherë pasi të keni kryer rezervimin, një e-mail me të gjitha detajet e rezervimit do të vijë në adresën tuaj.

PAGESA PER REZERVIMIN

Pagesa per rezervimin do te kryhet ne dy pjese: 50% e pageses do te kryhet ne momentin e rezervimit, 50% deri ne 21 dite para nisjes

Nëse dëshironi të ndryshoni specifikat e rezervimit tuaj, mund të na kontaktoni në një nga numrat e telefonit ose me e-mail.

POLITIKAT E KANCELIMEVE

Ne rast te anulimit nga klienti aplikohen penalitetet si me poshte :

40 % nese anulimi behet deri 30 dite perpara nisjes

75 % nese anulimi behet 30 deri ne 15 dite perpara nisjes 100% nese anulimi behet 14 dite perpara nisjes

Nese klienti qe kerkon te anulloje udhetimin e zevendeson rezervimin e tij me nje person tjetër, atehere politikat e anulimeve do te diksutohen sipas rastit konkret.

Anullimi do të quhet se është kryer në momentin që klienti paraqitet personalisht (ose i përfaqësuar nga një pjestar i grupit kur udhëtimi është rezervuar në grup) në njërin nga zyrat e agjencisë ose duke dërguar e-mail në adresën info@etg.al për t'u tërhequr nga marrëdhënia e krijuar me agjencinë.